



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167563
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05508036

KPPP.nr.1224/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Atlantik Group” Sh.P.K., me adresë në Preoc pn, Graçanicë, me NUI: 810792095, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S. avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.P “Next Market”, me emër tregtar E.R. B.I., me adresë rruga Vëllëzërit Fazliu 201 në Prishtinë, me NUI: 810489949, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.76/2022 të datës 07.04.2022, të Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datën 18.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.P “Next Market”, me emër tregtar E.R. B.I., Urdhri Përmbartimor P.nr.76/2022 i datës 07.04.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mubarak Shumolli, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhrin përmbartimor P.nr.76/2022 të datës 07.04.2022, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme - faturës tatimore AG2000000028947 të datës 10.12.2020 , faturës tatimore AG2000000028953 të datës 10.12.2020, faturës tatimore AG2000000028951 të datës 10.12.2020, faturës tatimore AG2000000030472 të datës 24.12.2020, faturës tatimore

AG2000000030471 të datës 24.12.2020, faturës tatimore AG2000000030476 të datës 24.12.2020, faturës tatimore AG2000000014139 të datës 06.07.2020, faturës tatimore AG2000000014138 të datës 06.07.2020, dhe faturës tatimore AG2000000014134 të datës 06.07.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që sipas faturave të lartcekura, brenda afatit prej 7 ditësh, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 3,276.60 Euro, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se kreditori propozimit për përmbartim nuk ia ka bashkangjitur dokumentet, përkatësisht faturat burimore në origjinal ose kopje të noterizuara, sikurse parasheh neni 36 pa.1 dhe neni 37 i LPP-së. Më tej ka shtuar se urdhri përmbartimor është i parakohshëm, ngase lëshimi i tij pa u bërë barazimi i kartelave financiare, nuk mund të kualifikohet si dokument i besueshëm në kuptim të nenit 29 par.1.3 të LPP-së, dhe nuk ka dokument të bashkangjitur me tiparet e përmbartueshmërisë në kuptim të nenit 71.1.1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që prapësimi të aprovohet si i bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor P.nr.76/2022 i datës 07.04.2022 të anulohet në tërësi.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit në prapësim, duke theksuar se urdhri përmbartimor është bazuar konform nenit 22,29 dhe 38 të LPP-së. Më tej ka shtuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara për arsye se në bazë të nenit 22 të LPP-së, kartela financiare nuk përbën dokument të besueshëm, prandaj fatura është bazë për përmbartim. Ka theksuar se të gjitha faturat e paraqitura si dokumente të besueshme në propozimin për përmbartim i plotësojnë kushtet ligjore, po ashtu të njejtat janë pranuar konform ligjit nga ana e debitorit, dhe janë të dorëzuara në origjinal tek Përmbartuesi Privat. Gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa ta lejoj urdhri përmbartimor të Përmbartuesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: "LPP") gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkak të si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura tatimore AG2000000028947 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000028953 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000028951 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000030472 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000030471 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000030476 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000014139 e datës 06.07.2020, fatura tatimore AG2000000014138 e datës 06.07.2020, dhe fatura tatimore AG2000000014134 e datës 06.07.2020, në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnim me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se fatura tatimore AG2000000028947 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000028953 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000028951 e datës 10.12.2020, fatura tatimore AG2000000030472 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000030471 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000030476 e datës 24.12.2020, fatura tatimore AG2000000014139 e datës 06.07.2020, fatura tatimore AG2000000014138 e datës 06.07.2020, dhe fatura tatimore AG2000000014134 e datës 06.07.2020, në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbnim dhe është lejuar urdhri përmbnimor janë bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar siç kërkohet me nenin 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, rezulton se propozimi për përmbnim mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri, përmbnim të meta ngase në propozim nuk janë treguar dokumentet origjinale apo kopja e vërtetuar mbi bazën e të cilëve është iniciuar procedura përmbnimore, ashtu siç përcaktohet me dispozitën nga neni 38 paragrafi 1 i LPP-së: i cili përcakton se *“Propozimi për përmbnim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbnim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbnimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Andaj, nga të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.76/2022 i datës 07.04.2022, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit të besueshëm dhe rrjedhimisht propozimi për përmbartim përmban të meta në kuptim të nenit 38 paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbartim, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbartimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga sa u theksua më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1224/23, më datë 18.03.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:167563
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05508036